



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

K.Dh.Sh.II.nr.952/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Dren Rogova, kryetar, Saranda Bogaj – Sheremeti dhe Franciska Zhitija - Ymeri, anëtarë, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “Vokshi & Lata” nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.617/18, të datës 15.10.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.01.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Arena Trade” ShPK me seli në Fushë Kosovë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrative, Divizioni Fiskal, A.nr.618/18, i datës 15.10.2021, Vërtetohet.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e ankimuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal, refuzohet si e pabazuar kërkesëpadia e Arena Trade ShPK me seli në Fushë Kosovë dhe mbetet në fuqi aktvendimi 01.3.2.2/84 i datës 26.02.2018 i Doganës së Kosovës në Prishtinë.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka ushtruar paditësi, me të cilën e konteston ligjshmërinë e tij për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa e paditësit Arena Trade ShPK, Ndryshohet aktgjykimi A.nr.617/19 i datës 15.10.2021 i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative-Divizioni Fiskal , ashtu që aprovohet kërkesëpadia e paditësit dhe anulohet aktvendimi i të paditurës Dogana e Kosovës nr.01.3.2.2/4 i datës 26.02.2018. Obligohet e paditura që paditësit t’ia pranoj vlerën e transaksionit realisht të paguar për mallin lëndor sipas DUD-ave R-571 të datës 12.01.2018, R-641 të datës 13.01.2018, R-694 të datës 15.01.2018, R-981 të datës 18.01.2018, R-1527 të datës 25.01.2018, R-1693 të datës 29.01.2018, R-2265 të datës 05.02.2018, R-2268 të datës 05.02.2018, dhe t’ia kthej mjetet e paguara më tepër

paditësit në emër të taksave doganore importuese në vlerë prej 10,112.70€ me kamatë vjetore prej 8% nga dita e paraqitjes së padisë në Gjykatë me datë 29.03.2018 e deri në pagesën definitive, ose që aktgjykimi i atakuar të priset dhe çështja t'i kthehet në rigjykim dhe rivendosje gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h, të Ligjit, nr.04/L-102, për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222, dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA, në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur, Doganës së Kosovës, nr.01.3.2.2/84 të datës 26.02.2018, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë, “Arena Trade” ShPK – Fushë Kosovë, për shqyrtimin e vendimeve nr. R-571/12.01.2018, R-641/13.01.2018, R-694/15.01.2018, R 981/18.01.2018, R 1527/25.01.2018, R 1693/29.01.2018, R 2265/05.02.2018, R 2268/05.02.2018 të ZBD Intereuropa.

Me këtë aktvendim, është konstatuar se Sektori i Pranimi Qendror, me datat e cekura si në Deklaratat Unike Doganore të lartcekura, subjektit në procedurë “Arena Trade” Sh.P.K – Fushë Kosovë i kanë kontestuar vlerën e deklaruar duke caktuar vlerë të re doganore, ndërsa në proceset mbi përcaktimin e vlerës së mallrave kanë cekur se malli lëndor është vlerësuar në bazë të metodës së gjashtë të vlerësimit nenit 35, të Kodit doganor dhe të Akcizave të Kosovës, përkatësisht të dhënave të disponueshme, që në rastin konkret janë marr të dhëna nga bursa për këtë lloj të mallit, si dhe janë inkorporuar shpenzimet e transportit në bazë doganore konform UA 06/2015.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurës, paditësi ushtron padi në gjykatën e shkallës së parë, e cila pas administrimit të provave si në procesverbalin e seancës së shqyrtimit kryesorë të mbajtur më datë 14.10.2021, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse, si në vështrim të nenit 44 të LKA-së, dhe vërtetimit të gjendjes faktike gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit, ndërsa lënë në fuqi Aktvendimin e Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/84 datë 26.02.2018. Në arsyetim të aktgjykimit ndër të tjera është theksuar se nga provat shkresore të administruara në këtë konflikt administrativ, gjykata nuk ka mundur të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se as në këtë konflikt administrativ paditësi nuk ka qenë në gjendje që gjykatës t'ia dëshmoj provat për të vërtetuar se vlera e mallit lëndor është vlera e vërtet e transaksionit e paguar për mallrat e shitura për eksport në Kosovë, siç parashihet me dispozitat e nenit 33 të kodit doganor dhe të Akcizave nr.03/L-109. Për të pranuar vlerën e paguar të transaksionit sipas metodës së parë të vlerësimit nga neni 33 të Kodit Doganor dhe të Akcizave të Kosovës 03/L-109, në këtë rast paditësi është dashur që të dëshmoj vlerën e transaksionit të cilin ia ka paguar shitësit – eksportuesit

të mallit lëndor. Edhe pse pala paditëse i ka prezantuar të paditurës dhe gjykatës provat materiale si Pro faturat, faturat e mallit dhe transferet bankare, mirëpo vlera e këtyre pagesave bankare nuk harmonizohet me vlerën e faturave të mallit lëndor.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të aplikueshëm sipas nenit 63 të Ligjit për Konfliktet Administrative. Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e aktvendimit të kontestuar në kuptim të nenit 81G të Ligjit Nr.04/L-102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr.03/L-222, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë ka konstatuar se kërkesëpadija e paditësit është e pa bazuar.

Sa i përket pretendimeve ankimore për vërtetim të gabuar të gjendjes faktike, janë të pa bazuara, ngase kolegji i kësaj gjykate konsideron se gjykata e shkallës së parë me rastin e shqyrtimit të padisë së paditësit ka nxjerrë prova të mjaftueshme të cilat vërtetojnë se pretendimet e paditësit janë të pa bazuara, kjo për faktin se nga provat e administruara, gjykata nuk ka mundur që të vërtetoj një gjendje tjetër faktike nga gjendja të cilën e ka konstatuar organi i paditur gjatë procedimit administrativ, për arsye se paditësi nuk ka prezantuar fakte të bazuara që argumentojnë se ka paguar vlerën reale të mallit sipas faturave përcjellëse të mallit lëndor, pasi që urdhërpagesat ndërkombëtare të datës 09.01.2018, 10.01.2018, 12.01.2018, 19.01.2018, 18.01.2018, 31.01.2018 Pro Credit Bank, me status të aprovuar, nuk kanë të njëjtën vlerë me faturat e mallit lëndor të deklaruara nr.01/1/11/01.2018, nr.100/2018 datë 11.01.2018, nr.2/1 datë 11.01.2018, 101/2018 dt.17.01.2018, 06/01, 20/01 dt.02.02.2018, 18/1 dt.01.02.2018. këtë mosharmonizim të këtyre dokumentacioneve pala paditëse nuk e ka kontestuar por ka kërkuar që të pranohet vlera e transaksionit në pazë të pagesave sipas profaturave të mallit.

Nga tërë kjo që u cekë më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga gjykata e shkallës së parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin e refuzimit të kërkesëpadiisë së paditësit, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të

vihet në pyetje, ankesa e paditësit, u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.Dh.Sh.II.nr.952/22, me datë 26.01.2024

Kryetari i kolegjit, gjyqtari

Dren Rogova